



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORATI I INSPEKTORATIT

Gjatë këtij muaji kemi punuar rreth identifikimit të bizneseve të pa regjistruara MTI, dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjeno sanitare. Kemi kontrolluar marketet ushqimore nëpër qytet dhe fshatra, bizneset rreth aftashmërisë së mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, faturat e furnizimit me mallë dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve, çmimet e vendosura në artikuj, si dhe respektimin e ligjit të duhanit kryesisht restorantet dhe kafiterit etj. Kemi bërë fletëparaqitje për kundërvajtje për shkak se gjatë inspektimit kemi hasur në parregullsi ku nuk i është dhënë fatura konsumatorëve, po ashtu kemi kontrolluar barnatoret humane dhe bujqësore nëpër qytet dhe fshatra ku në një barnatore humane kemi gjetur produkte farmaceutike pa banderola dhe pa fatura te furnizimit i kemi larguar nga shitja dhe i kemi izoluar barnat dhe i kemi njoftuar inspektorët e shëndetësisë ku se bashku me ne kemi shkuar ne barnatoren ne fjalë dhe i janë konfiskuar barnat dhe jemi njoftuar me shkrim se biznesi ne fjalë është gjobitur me 1000 euro për arsye te mallit pa origjinë dhe pa banderola.

Këtë muaj e kemi përfunduar aksionin e inspektimit të furrave të bukës. Në të gjitha furrat është vërejtur një gjendje higjenike-sanitare në suazat e normales.

Gjithashtu në bazë të planit dinamik të punës kemi filluar me një aksion për inspektimin fabrikave për prodhimin e produkteve të qumështit. Në to u konstatoi se qumështoret për fat të mirë ishin duke u prodhuar me standarde evropiane komfor ligjeve në fuqi

Kemi inspektuar ne disa fshatra si: Topliqan i Vjetër, Shalë, Ribar i Madh, Krojmir, Zllakuqan, Miren ku qëllimi i inspektimit ishte rreth problemeve me ujërat e zeza, hedhjes së mbeturinave dhe plehrave në hapësira publike dhe ndotjes së ambientit në përgjithësi. Ndaj të gjitha parregullsive janë marrë masa ligjore. Janë inspektuar deponit ilegale të mbeturinave në qytetin e Lipjanit dhe disa fshatra.

Kemi mbajtur një takim me zyrtarë të MMPH-së në lidhje me zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Lejen Mjedisore Komunale, dhe identifikimi se sa biznese janë në K. Lipjanit që duhet t'i nënshtrohen kësaj leje komunale. Është bërë identifikimi në teren i të gjitha bizneseve që duhet të kenë LMK dhe u janë dërguar zyrtarëve të MMPH.

Gjatë tër muajit kemi bërë inspektim të vazhdueshëm në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrellë ku kemi organizuar aksion në bashkëpunim me policin kufitare të Aeroportit në lidhje me disa auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, pra për ata të cilët i kemi hasur duke ushtruar veprimtari ilegale janë marr masat ndëshkimore ndaj dy auto-taksive ilegal në bazë të Ligjit. Po ashtu është bërë inspektimi në të gjitha rrugët e Lipjanit ku janë inspektuar auto-taksit të cilët janë të vendosur në këtë rrugë dhe auto- parkingje. Ne Lipjan nuk kemi asnjë auto taxi- ilegal i cili është duke operuar me përjashtim ne disa fshatra të Shalës dhe rrethin ku janë hasur tre kombi taxi ilegal ndaj të cilëve janë marr masa ligjore.

Po ashtu gjatë këtij muajit janë inspektuar- kontrolluar edhe kompanitë e autobusëve të cilat operojnë në Komunën e Lipjanit në lidhje me rendin e udhëtimit se a janë duke e respektuar dhe është bërë kontrollimi për Licensë.

Gjatë këtij muaji në vazhden e inspektimeve ishin barnatoret bujqësore në qytet dhe në disa fshatra ku është inspektuar për afatshmërin e pesticideve në bazë të Ligjit Nr. 2003/20 , Licensat e farërave në bazë të Ligjit Nr.2003/5, plehrave në bazë të Ligjit Nr. 2003/10, ushqimet e kafshëve dhe koncentratet në bazë të Ligjit Nr. 03/L-029. Për të gjitha parregullsitë kam vepruar komfor Ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

Në disa raste kemi atakuar pesticide me afat të skaduar të cilat janë larguar nga shitja sipas Ligjit për pesticide Nr. 2003/20 dhe në disa pako me fara të perimeve të cilat janë asgjësuar në vend sipas Ligjit për Farëra Nr. 2003/5

Gjatë këtij muaji janë inspektuar objektet në vend punishte nëpër qytet si objekte me leje ndërtimore ku është përcjellë faza e punimeve ndërsa për objektet tjera janë marr masa komfor ligjit të ndërtimit për ndalim te punimeve ilegale të cilat objekte janë duke u përcjellur vazhdimisht se mos janë duke vazhduar punimet.

Objektive kryesore e drejtorisë sonë është qe te pajisen pronaret me leje ndërtimore dhe te mos ketë ndërtime pa leje. Këtij objektivi ja kemi arritur qëllimin ku gjerë me sot në komunën tonë nuk kemi asnjë objekt ndërtimor pa leje ndërtimi.

Të dhënat statistikore më të hollësishme janë të paraqitura në tabelën e më poshtme:

**Pasqyra tabelare e punës:**

| <b>Inspektorët</b>   | <b>Gjithsej</b> | <b>Inspektime me procesverbal</b> | <b>Pranime teknike</b> | <b>Fletëparaqitje për kundërvajtje</b> | <b>Inspektime për pirjen e duhanit</b> | <b>Vërejtje, njoftime</b> | <b>Inspektime për orar të punës</b> | <b>Lëndë e ekzekutuara gjyqësore</b> | <b>Inspektime të përbashkëta</b> | <b>Gjorbë mandatore</b> | <b>Inspektim i auto-taxi</b> | <b>Menaxhim i tregjeve</b> | <b>Aktivendime- ndalesa, urdhëresa</b> | <b>Kërkesa, pune me palë</b> | <b>Mall pa afat të skaduar</b> | <b>Inspektim i kafshëve në thetore</b> | <b>Inspektime me polici</b> | <b>Inspektim për farëra, plehradhe pesticide</b> | <b>Mbyllje të lokaleve afariste</b> | <b>Biznese të pajisjeshme, pajisje teknike, per çmime</b> |
|----------------------|-----------------|-----------------------------------|------------------------|----------------------------------------|----------------------------------------|---------------------------|-------------------------------------|--------------------------------------|----------------------------------|-------------------------|------------------------------|----------------------------|----------------------------------------|------------------------------|--------------------------------|----------------------------------------|-----------------------------|--------------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------------------------------------|
| <b>Biznesit</b>      | <b>480</b>      | <b>41</b>                         | <b>2</b>               | <b>3</b>                               | <b>94</b>                              | <b>61</b>                 |                                     |                                      | <b>41</b>                        |                         |                              | <b>8</b>                   | <b>36</b>                              | <b>150</b>                   |                                |                                        | <b>1</b>                    |                                                  | <b>13</b>                           | <b>40</b>                                                 |
| <b>Ambientit</b>     | <b>213</b>      | <b>24</b>                         |                        | <b>1</b>                               |                                        | <b>3</b>                  |                                     | <b>1</b>                             | <b>80</b>                        |                         |                              |                            |                                        | <b>98</b>                    |                                |                                        | <b>6</b>                    |                                                  |                                     |                                                           |
| <b>Bujqësisë</b>     | <b>115</b>      | <b>13</b>                         |                        |                                        |                                        |                           | <b>29</b>                           |                                      | <b>49</b>                        |                         |                              |                            | <b>7</b>                               | <b>5</b>                     |                                |                                        |                             | <b>12</b>                                        |                                     |                                                           |
| <b>Ndërtimtarisë</b> | <b>100</b>      | <b>20</b>                         |                        |                                        |                                        |                           |                                     |                                      | <b>52</b>                        |                         |                              | <b>3</b>                   | <b>2</b>                               | <b>23</b>                    |                                |                                        |                             |                                                  |                                     |                                                           |
| <b>Trafikut</b>      | <b>402</b>      | <b>43</b>                         |                        | <b>1</b>                               |                                        | <b>73</b>                 |                                     | <b>5</b>                             | <b>36</b>                        |                         | <b>113</b>                   | <b>8</b>                   |                                        | <b>43</b>                    |                                |                                        | <b>80</b>                   |                                                  |                                     |                                                           |
| <b>Sanitar</b>       | <b>291</b>      | <b>27</b>                         |                        |                                        | <b>88</b>                              | <b>57</b>                 |                                     | <b>3</b>                             | <b>70</b>                        |                         |                              |                            | <b>11</b>                              | <b>19</b>                    | <b>6.5€</b>                    | <b>15</b>                              |                             |                                                  | <b>1</b>                            |                                                           |
| <b>Gjithsejtë</b>    | <b>161</b>      | <b>168</b>                        | <b>2</b>               | <b>5</b>                               | <b>182</b>                             | <b>194</b>                | <b>29</b>                           | <b>9</b>                             | <b>328</b>                       |                         | <b>113</b>                   | <b>19</b>                  | <b>56</b>                              | <b>338</b>                   | <b>6.5€</b>                    | <b>15</b>                              | <b>87</b>                   | <b>12</b>                                        | <b>4</b>                            | <b>40</b>                                                 |